Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**05.10.2023**	**13.10.2023**	**2023/0757**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.10.2023, OE "Edona " Sh.p.k."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0757, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE " Edona " Sh.p.k."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i objektit II per nevoja te komunes ne fshatin Gerlice, Ferizaj" me nr. të prokurimit: "656-23-3448-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës:200,000.00€ .Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/435 i dt:04.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit Neni 27

Dosja e Tenderit

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose

Profesionale

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 108/A, - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Neni 130 Ndikimi i Paligjshëm .

AK – Komuna Ferizaj, për aktivitetin e prokurimit: "***Ndërtimi i objektit II për nevojat e komunës ne fshatin Gerlice, Ferizaj", me nr te prokurimit 656-23-3448-5-2-1,*** me patjetër po insiston qe te lidhe kontrate te kundërligjshme përkundër faktit se oferta e te njëjtit OE eshtë konstatuar se ka tejkaluar vlerën e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Kompania jone dhe grupi ynë i OE – ve si rezultat i shkeljeve ligjore eshtë dëmtuar thelle ne aspekt moral dhe atë material, si rezultat i raportimit te shkeljeve ligjore raportimit te abuzimit me paranë publike abuzimit me pozitën zyrtare.

Tani me eshtë hera e trete qe grupi ynë kërkon qe te respektohen dispozitat e ligjit te vlerësohen ofertat ligjshëm dhe te mos manipulohet me dheshmit dokumentare dhe te mos ndërrohet destinomi i dokumentacionit tone te dorëzuar ne oferte.

Pretendimet Ankimore

Operatori ekonomik ankues Edona Sh.P.K. & Murseli Company Sh.P.K &

Konstruktori ING 1969 Sh.P.K, edhe rivlerësimin e fundit te ofertave e ka kundërshtuar përfshire edhe arsyetimin e eliminimit pas AK Komuna Ferizaj, dhe zyra e prokurimit ka potencuar se kompanisë sonë i mungon libreza valide për mjetin e punës Auto mikser vetëngarkues për prodhimin e betonit.

Sipas raportit te rivlerësimit, komisioni rivlerësues i ofertave, ne kundërshtim me vendimin Nr. 435/2023 te datës 04.09.2023, përsëri insiston ne eliminim te ofertës sonë si te papërgjegjshme përkundër faktit se ne vendimin e mëparshëm te OSHP-se për ketë procedure te prokurimit paneli shqyrtues e ka obliguar autoritetin kontraktues qe: **"...** ***megjithatë paneli konsideron se ne kontekstin e fakteve dhe rrethanave te analizuar si me sipër kthimi i këtij aktiviteti te prokurimit ne rivlerësim ka baze ligjore dhe atë duke u nisur ne parimet baze te dispozitës se nenit 7 te LPP-se – barazimi ne trajtimi – mosdiskriminim, ne mënyre qe palët te trajtohet ne mënyre te barabarte dhe pa diskriminim te shterren te gjitha mundësit duke kërkuar sqarime shtese nga OE dhe autoritetet kompetente ashtu siç përcaktohet me nenin 59 dhe 72 te LPP-se, dhe për te pasqyruar sakte gjendjen reale te këtij mjeti te kontestuar duke ardhur ne përfundimin***

se dëshmitë e ofruara plotësojnë apo jo kërkesën e AK-se."

Shiko si prove vendimin nr. 435/2023 te datës 04.09.2023, faqe 5.

Neni 59 i LPP-se i LPP-se, përcakton përgjegjësit qe merr secili anëtar i Komisionit veç e veç. Shkeljet ligjore te zyrës se prokurimit te AK Komuna Ferizaj dhe anëtareve te Komisionit te rivlerësimit te ofertave bien ndesh me konstatimet e panelit shqyrtues sipas vendimit me Nr. 435/2023 te datës 04.09.2023, ku përveç tjerash eshtë konstatuar se AK sipas raportit te rivlerësimit te ofertave, nuk eshtë zbatuar vendimi i panelit shqyrtues dhe te gjeturat e panelit shqyrtues sipas vendimit te larte cituar, dhe fare nuk eshtë kërkuar sqarim nga ne si OE ankues, apo edhe nga organet kompetente lidhur me pajisjen Auto mikser, nëse eshtë ekuivalente dudi doganor dhe libreza e qarkullimit rrugor.

OSHP, dhe paneli shqyrtues, përmes vendimeve tjera kur ligjet përkatëse te një fushe te caktuar apo amendamentit e tyre lejojnë ekuivalenca, vet OSHP e ka trajtuar si kërkese te plotësuar.

Shembull: AK ka kërkuar certifikate për asgjësim te produkteve mjekësore, OE ka prezantuar leje mjedisore eshtë trajtuar si kërkese e plotësuar.

AK, ka kërkuar Diplome universitare, OE ka prezantuar vërtetim dhe konfirmim te mbarimit te studimeve, nga OSHP dhe ligjërisht kemi te bëjmë ke kërkese te plotësuar.

Ngjashëm kemi te bëjmë edhe tani neve si kompani e kemi prezantuar Auto mikserin, e kemi prezantuar edhe dokumentin Unik Doganore, dokument ky qe e lejon pajisjen te funksionoj ne punishte siç e parasheh ligji për qarkullim rrugor dhe ligjet tjera ne fuqi.

AK – Komuna Ferizaj tani e rreth një vit e zvarrit ketë procedurë te prokurimit madje nuk e zbaton as vendimin e OSHP-se, ligjërisht detyrues për AK-ne.

Keqpërdorimi ne prokurim publik, keqpërdorimi i parëse publike dhe insistimi i AK- se qe te lidhet kontrata me operatorin ekonomik i cili ka tejkaluar dhe vlerën e parashikuar te kësaj kontrate, dhe zvarritjet se procesit me qellim duhet te raportohet edhe nga OSHP tek organet kompetente dhe te ndërmarri masa ligjore ndaj zyrtareve përgjegjës.

Grupi ynë i OE-ve eshtë dëmtuar dhe ne vazhdimësi po dëmtohet si rezultat i shkeljeve ligjore përfshire përgatitjen përpilimin e shkresave, deponimin e depozitës se ankesës dhe shumë qeshje tjera.

AK, për tejkalim te buxhetit ka arsyetuar se zyra e financave ka rrit vlerën e tejkaluar te buxhetit nga AK. Kjo qeshje tregon për favorizim te hapur te OE te rekomanduar dhe diskriminim te hapur te kompanisë sonë, përkundër faktit se ne si grup i OE-ve kemi prezantuar oferte te përgjegjshme.

Ne si Grup i OE-ve përmes kërkesës për ri shqyrtim kemi kërkuar nga AK qe te respektohet vendimi i OSHP-se, te kërkohet sqarim nga Organi kompetent, dogana e Kosovës apo edhe Qendra e regjistrimit te Automjeteve ashtu siç eshtë obliguar AK – ne vendimin e OSHP-se, megjithatë AK, nuk ka ndërmarr hapa dhe ka eliminuar ofertën tone përsëri si te pa përgjegjshme me arsyetimin e njëjte si ne vlerësimin e pare.

Prandaj grupi ynë i OE-ve, kërkon nga OSHP, eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues qe ti ndërmerr masat ligjore ndaj AK-se meçe pika h) e ndenit 97, te RRPP-se, mos respektimin e vendimit te OSHP-se, e kualifikon si shkelje te rende, përfshi edhe pikat tjera, qe lidhen me favorizim, diskriminim keqpërdorim dhe tentim për përvetësim te parës publike dhe shumë qeshje tjera ta njoftoj KRPP-se dhe te behet revokimi i certifikatës ndaj zyrtarit përgjegjës te AK – Komuna Ferizaj/

Grupi i OE-ve Edona Sh.P.K, Murseli Company dhe Instruktori Sh.P.K., bazuar ne këto

fakte te prezantuara si me larte, kërkon nga OSHP, qe ta ushtroi funksionin e saje sipas

Grupi i OE-ve Edona Sh.P.K, Murseli Company dhe Instruktori Sh.P.K., bazuar ne këto

fakte te prezantuara si me larte, kërkon nga OSHP, qe ta ushtroi funksionin e saje sipas

nenit 105, te LPP-se dhe ta obligoi AK – Komunën e Ferizajt, qe ti zbatoi dispozitat ligjore dhe te nxjerr ketë:

V E N D I M

Te aprovohet, ankesa jone si e bazuar

Te kthehet lënda ne ri vlerësim dhe te korrigjohen shkeljet ligjore te konsumuara

dhe te raportuara dhe te zbatohet vendimi i OSHP-se.

Te kërkohet nga KRPP qe sipas nenit 25.8 te LPP-se qe re revokohet certifikata e Prokurimit publik për zyrtarin përgjegjës te prokurimit te AK-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lista e mjeteve te punes 1.kamion kiper 1 cope, 2.automikser vet ngarkues per prodhim te betonit, 3.kamionet 2 cope, 4.makin per ndertimin e mikrotuneleve horizontale nentoksore me sistem laser, 5. eskavator 1 cope, 6. Vinq mbi shasi me rrota	**Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal si deshmi kopje dokumentit te regjistrimit,libreza valide per pikat 1,2, dhe 3 , ndersa per pjesen tjeter duhet te deshmohet me dud doganor ose fatur te blerjes te deshmuar me pagese bankare.Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar ne prezence te te dya paleve**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

ZYRA E PROKURIMIT
KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
PROCUREMENT OFFICE

Tel.:03820046045
E- mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: "Ndërtimi i objektit II për nevoja të Komunës në fshatin Gërlicë, Ferizaj"

Numri i aktivitetit të prokurimit: 656-23-3448-5-2-1

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës (€)
1.	**Grup i Operatorëve Ekonomik VALI INVEST SH.P.K.; AL-BER SH.P.K., Ferizaj, 70000, Ferizaj**	**300 271.80 €**
2.	**Grup i Operatorëve Ekonomik Edona Sh.p.k.; Company Murseli SH.P.K.; "Konstruktori Ing.1969 Sh.p.k., D.e Kombit Ban.e Solidaritetit, 70000, Kosovo**	**249 758.69 €**

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:
Komuna Ferizaj - Zyra e Prokurimit **shpërblen** me kontratë:
Grupin e Operatorëve Ekonomik VALI INVEST SH.P.K.; AL-BER SH.P.K., Ferizaj, 70000, Ferizaj
në vlerë të ofertës: **300 271.80 €**

Data: 14.09.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP: Arbërie Bekteshi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

PSH.Nr. 2023/435 i dt:04.09.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Edona " Sh.p.k.**

Autoriteti Kontraktues- Komuna Ferizaj gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 200,000.00€ për vitin 2023 dhe 100,000.00 € për vitin 2024. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Ekspertja shqyrtuese, sqaron se kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, me ç 'rast është nxjerr raporti i ekspertizës me nr.435-2023 i datës 10.07.2023, si dhe Paneli Shqyrtues ka nxjerr Vendim PSH.nr.435/2023 të datës 04.09.2023.

AK Komuna Ferizaj, pas vendimit PSH.nr.435/2023 të datës 04.09.2023, ka bërë ri vlerësimin e ofertave dhe me datë 14.09.2023, ka nxjerr B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik "Vali Invest" shpk AL-BER –Sh.p.k –Ferizaj. I pa kënaqur me këtë njoftim, OE ankues "Edona" sh.p.k paraqet kërkesë për rishqyrtim tek AK, ku AK përmes vendimit të datës: 25.09.2023, ka refuzuar kërkesën për ri shqyrtim si të pa bazuar të OE ankues me arsyetimin se kanë respektuar në tërësi rekomandimin e Panelit shqyrtues, por sërish gjatë rivlerësimit keni rezultuar si operator ekonomik i papërgjegjshëm pasi nuk keni plotësuar kërkesat e njoftimit për kontratë.....

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore OE ankues "Edona" sh.p.k, që pretendon se AK- Komuna Ferizaj, ka vepruar në kundërshtim me 7, 24, 27, 51, 60, 62, 108/A dhe 130 të LPP-së. OE ankues shton se komisioni rivlerësues i ofertave në kundërshtim me vendimin PSH.nr.435/2023 të datës 04.09.2023, përsëri ka eliminuar ofertën e tij si të papërgjegjshme përkundër faktit se vendimi i OSHP-së ka obliguar autoritetin kontraktues që "... *megjithatë paneli konsideron se ne kontekstin e fakteve dhe rrethanave te analizuar si me sipër kthimi i këtij aktiviteti te prokurimit në rivlerësim ka baze*

ligjore dhe atë duke u nisur ne parimet baze te dispozitës se nenit 7 te LPP-së – barazimi ne trajtimi –mosdiskriminim, ne mënyre qe palët te trajtohet ne mënyre te barabarte dhe pa diskriminim të shterren të gjitha mundësit duke kërkuar sqarime shtese nga OE dhe autoritetet kompetente ashtu siç përcaktohet me nenin 59 dhe 72 te LPP-se, dhe për te ***pasqyruar sakte gjendjen reale te këtij mjeti te kontestuar duke ardhur në përfundimin se dështmitë e ofruara plotësojnë apo jo kërkesën e AK-se."***

Ekspertja shqyrtuese, bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht në vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim të datës 25.09.2023, ku AK thekson *"...lidhur me pajisjen se është dashur të kërkojë sqarime konform nenit 72 të LPP-së, përpos që dispozitat ligjore tregon se fjala* ***"mund"*** *nuk ka karakter obligativ për AK-në komisioni i rivlerësimit nuk ka parë të nevojshëm dhe të arsyeshëm qe për një pajisje të tillë është faktike dokumenti i cili tregon se ju nuk keni ofruar asnjë librezë lidhur me pajisjen e kërkuar sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë...."*.

Ekspertja shqyrtuese sqaron pavarësisht që OSHP përmes vendimit ka obliguar AK "...të pasqyrojë sakte gjendjen reale te këtij mjeti të kontestuar duke ardhur në përfundimin se dështmitë e ofruara plotësojnë apo jo kërkesën e AK-se.", AK nuk e ka bërë një gjë të tillë me arsyetimin se dispozita e nenit 72 të LPP-së lejon mundësinë "mundet" dhe kjo dispozitë nuk ka karakter obligativ për Autoritetin kontraktues. **Ekspertja shqyrtuese** vlerëson se fjala "mund" e cila ceket në nenin 59 dhe 72 të LPP-së, dhe të cilës i referohet AK, vlen gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ku fjala "mund" nënkupton se AK nëse e sheh të arsyeshme mund të kërkoj sqarime shtesë apo nëse nuk e sheh të arsyeshme mund të mos kërkoj sqarime shtesë. Mirëpo, në rastet kur OSHP nxjerr një vendim dhe i jep udhëzime autoritetit kontraktues, sikurse në rastin konkret e udhëzon që të pasqyroj gjendjen reale të mjetit të kontestuar nëse e plotëson kërkesën e AK-së, në raste të tilla AK nuk mund të arsyetohet në fjalën "mund" që të mos zbatoj vendimin e OSHP-së. Andaj, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se AK është dashur që të marrë parasysh vendimin e OSHP-së dhe të veproj konform udhëzimeve të dhëna në këtë vendim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, ku ka marr shembuj se si OSHP dhe paneli shqyrtues përmes vendimeve tjera kur ligjet përkatëse të një fushe të caktuar apo amendamentimit të tyre lejohet ekuivalenca dhe OSHP i ka trajtuar si kërkesa te plotësuara si:

"AK ka kërkuar certifikate për asgjësim të produkteve mjekësore, OE ka prezantuar leje mjedisore është trajtuar si kërkese e plotësuar."

"AK, ka kërkuar Diplome universitare, OE ka prezantuar vërtetim dhe konfirmim të mbarimit te studimeve, nga OSHP dhe ligjërisht kemi te bëjmë me kërkese të plotësuar."

Tutje OE ankues shton se ngjashëm kemi të bëjmë edhe tani neve si kompani e kemi prezantuar Auto mikserin, e kemi prezantuar edhe dokumentin Unik Doganore, dokument ky që e lejon pajisjen të funksionoj në punishte siç e parasheh ligji për qarkullim rrugor dhe ligjet tjera në fuqi.

Ekspertja shqyrtuese i sqaron OE ankues se është e autorizuat për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk mund të bëjë krahasime me aktivitete tjera, dhe aq më pak ti komentoj vendimet dhe veprimet e Panelit shqyrtues se si i ka trajtuar kërkesat e ndryshme të plotësuara apo jo të plotësuara. Sido që të jetë, ekspertja në raportin paraprak e ka pasqyruar pretendimin ankimor lidhur me pajisjen "Auto miskër" dhe ka dhënë përgjigje për këtë çështje.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor se AK ka tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë kontratë dhe arsyetohet se zyra e financave ka rrit vlerën e tejkaluar të buxhetit**. Ekspertja shqyrtuese e** ka trajtuar këtë pretendim ankimor, ku edhe paneli shqyrtues ka nxjerr vendiminPSH.nr.435/2023 të datës 04.09.2023, duke e obliguar autoritetin kontraktues: *"AK që gjatë ri-vlerësimit dhe ekzaminimit te tenderit të këtë parasysh nenin 59.3 të LPP-së, duke i përmirësuar gabimet te cilat janë tërësisht aritmetike.ne raste te tilla çmimi për njësi i ofruar nga operatori ekonomik ne tenderin e tij financiar gjithmonë do te konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor si dhe qe pas përmirësimeve te tilla te mos ketë ndryshime +-2% te vlerës totale te tenderit.*

Ekspertja shqyrtuese, bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht në vendimin ndaj kërkesë për rishqyrtim të datës 25.09.2023, AK thekson *"...AK ka vepruar ne harmoni me vendimin PSH.nr.435/2023 të datës 04.09.2023, ku ka bere përmasimin e nevojshëm konform nenin 59.3 dhe 40.9.40.10 të Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik ku pas konfirmimit nga OE ne lidhje me llogaritjen e gabuar ka marr edhe aprovimin nga drejtoria komunale përkatëse se ka mjete shtesë për ketë aktivitet te prokurimit dhe mund te vazhdohet për shkak se kjo procedure është e një rëndësie te veçantë për qytetaret e kësaj komune dhe është interese publik qe të*

përfundohet sa me shpejtë qe është e mundur."

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se është bashkangjitur Letra standarde e kërkesës për sqarim te tenderit llogaritje e gabuar e datës 12.09.2023, si dhe shkëmbimi i kërkesës zyrtare për aprovimin emjeteve të kërkuara.

Provë:

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

ZYRA E PROKURIMIT
KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
PROCUREMENT OFFICE

Tel.:03820046045
E- mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit llogaritje e gabuar

12.09.2023

Komuna Ferizaj

Grupin e Operatorëve Ekonomik – VALI INVEST SH.P.K.; AL-BER SH.P.K., Ferizaj, 70000, Ferizaj

Nr. i prokurimit:	656	23	3448	5-2-1

Titulli: Ndërtimi i objektit II për nevoja të Komunës në fshatin Gërlicë, Ferizaj

I/e nderuar(a)
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim " LPP ".

Gjatë ekzaminimit të tenderit të juaj kemi gjetur gabim(e) aritmetik(e). Gabimi ose gabimet kanë të bëjnë me:

- *Në paramasën e ofertës tuaj, tek pjesa **F - Paramasa dhe parallogaria për Ujësjellës dhe Kanalizim**, respektivisht ne totalin e pjesës **F.1 Rrjeti i Ujësjellësit**, shuma totale të cilën e keni përshkruar Ju është 1020 e në fakt duhet të jetë **1320 Euro.***

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur ne kemi korrigjuar gabimin (gabimet) duke bërë amendamentet vijuese të tenderit të juaj:

Nëse **nuk** pajtoheni me ketë (këto) amendament(e), ju lutem të na kontaktoni menjëherë **me shkrim** në adresën elektronik ***e-prokurimi*** apo në email adresën: **prokurimi.ferizaj@rks-gov.net.**

Me respekt,

A. Bekteshi, _____
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

_____
[Nënshkrimi]

10/11/23, 11:31 AM Kerkese - Prokurimi Ferizaj

Kerkese

Prokurimi Ferizaj

Tue 9/12/2023 14:56

To:Arben Halili <Arben.Halili@rks-gov.net>;

Cc:Agim Aliu <Agim.Aliu@rks-gov.net>;

Përshëndetje e nderuar,
Uroj të jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ne aktivitetin e Prokurimit **Ndertimi i objektit II per nevoja te komunes ne fshatin Gerlicë, Ferizaj,** me nr te prokurimit **656-23-3448-5-2-1** në bazë të procesverbalit të hapjes së tenderit të datës 19.06.2023 kemi një ofertë te pergjegjshme, mirpo vlera e parashikuar e ketij aktiviteti është **300,000.00 €,** ndërsa Operatori Ekonomik ka ofertuar në vlerë **300,271.80 €**, pra Operatori Ekonomik e ka tejkaluar vlerën e parashikuar të ketij aktiviteti, ju si Drejtori a mund t'i siguroni këto mjete shtesë nëse ju dëshironi të vazhdojmë me procedurën e vlerësimit.

Ne jemi në fazën e vlerësimit të ofertave, andaj për të vazhduar më tutje me vlerësimin, ju lutemi që të na jepni përgjigje në afatin sa më të shpejtë të mundshëm në mënyrë që ne të vazhdojmë me procedurën.

Ju faleminderit per mirekuptimin tuaj

Me Respekt!

Zyra e Prokurimit, Komuna Ferizaj.

10/11/23, 11:33 AM FW: Kerkese [UNSCANNED] - Prokurimi Ferizaj

FW: Kerkese [UNSCANNED]

Arben Halili

Wed 9/13/2023 11:16

To:Prokurimi Ferizaj <Prokurimi.Ferizaj@rks-gov.net>;

Cc:Sebahate Sadiku <Sebahate.Sadiku@rks-gov.net>; Lulzim Aliu <lulzim.aliu@rks-gov.net>;

Përshëndetje të nderuar!

Meqenëse jemi në proces të hartimit të buxhetit për vitin 2024, atëher kemi mundësi të sigurojm edhe këto mjete shtesë për realizimin e këtij projekti.
Për të mos humbur kohë në kthimin prapa të këtij projekti shumë të rëndësishëm për Komunën e Ferizajt, ju sugjerojm që të vazhdoni proceduart e vlerësimit nëse nuk ka ndonjë pengesë tjetër ligjore.

Ju falenderoj për bashkpunimin e treguar;

Me respekt,

Arben Halili
Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
Arben.halili@rks-gov.net
Kontakti : 049 995 700

From: Prokurimi Ferizaj <Prokurimi.Ferizaj@rks-gov.net>
Sent: Tuesday, September 12, 2023 2:57 PM
To: Arben Halili <Arben.Halili@rks-gov.net>
Cc: Agim Aliu <Agim.Aliu@rks-gov.net>
Subject: Kerkese [UNSCANNED]

Përshëndetje e nderuar,
Uroj të jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ne aktivitetin e Prokurimit **Ndertimi i objektit II per nevoja te komunes ne fshatin Gerlicë, Ferizaj**, me nr te prokurimit **656-23-3448-5-2-1** në bazë të procesverbalit të hapjes së tenderit të datës 19.06.2023 kemi një ofertë te pergjegjshme, mirpo vlera e parashikuar e ketij aktiviteti është **300,000.00 €,** ndërsa Operatori Ekonomik ka ofertuar në vlerë **300,271.80 €**, pra Operatori Ekonomik e ka tejkaluar vlerën e parashikuar të ketij aktiviteti, ju si Drejtori a mund t'i siguroni këto mjete shtesë nëse ju dëshironi të vazhdojmë me procedurën e vlerësimit.

Ne jemi në fazën e vlerësimit të ofertave, andaj për të vazhduar më tutje me vlerësimin, ju lutemi që të na jepni përgjigje në afatin sa më të shpejtë të mundshëm në mënyrë që ne të vazhdojmë me procedurën.

Ju faleminderit per mirekuptimin tuaj

Me Respekt!

Zyra e Prokurimit, Komuna Ferizaj.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që kërkon nga ekspertit shqyrtues dhe paneli shqyrtues, që ti ndërmerr masa ligjore ndaj AK-së meqë pika h) e nenit 97 të RRPP-së, mos respektimit i vendimit te OSHP-së, kualifikon si shkelje e rëndë, përfshi edhe pika tjera, që lidhen me favorizim diskriminim keqpërdorimi dhe tentim për përvetësim të parasë publike dhe shumë

çështje tjera që njoftoj KRPP dhe të behet revokimi i certifikatës ndaj zyrtarit përgjegjës të AK Komuna Ferizaj. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se ekspertit nuk ka kompetencë që të ndërmerr masa ligjore ndaj AK-së ashtu siç ka pretenduar OE ankues por neni 97.1 i Rregullores për prokurim publik i konsideron si shkelje te rënda gjashtëmbëdhjeta (16) veprimet në prokurim publik, andaj nuk mund të paragjykoj në përfundimin e kësaj lënde dhe është kompetenca e OSHP-së, Panelit shqyrtues të ndërmerr masa ligjore ndaj autoriteteve kontraktuese.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Edona " Sh.p.k.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli